



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:290385
Datë: 09.07.2024
Numri i dokumentit: 05914860

SCC - 09 – 0204

Paditësit:

M D nga K, Republika e Serbisë e me numër personal .. dhe V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës numër personal .. e të cilët me autorizim i përfaqëson, av.D L nga Graçanica e të cilin me autorizim zëvendësues e përfaqëson, av. J Fnga Graçanica.

Kundër:

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Kolegjin e saj në përbërje me gjykatësin, Agron Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësin, Hasim Sogojeva dhe gjykatësin, Murat Hulaj, anëtarë të kolegjit, jashtë seancës dëgjimore, me **dt.09.07.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procesi gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së njërit nga paditësit, V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës.

II. Procesi gjyqësor i ndërprerë mund të vazhdohet kur trashëgimtarët ligjor, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore të paditësit, e marrin përsipër procedurën në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Paditësit, me dt.04 mars 2009, në Dhomëm e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGjSK), pranë kanë paraqitur padinë kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe atë për shkak të objektit të kontestit – Anulimim i kontratës së

Privatizimit, Nr.596/2006 së bashku me Deklaratën e Transferimit, Nr.596/2006 të dt.01 Nëntor 2006 si dhe konfirmimit të të drejtave të tyre të pronësisë për parcelat e tokës, nr., nr., nr., nr. dhe nr.. të regjistruara në fletën poseduese, nr., Komuna e Fushë Kosovës, Zona Kadastrale, B.

Paditësit, kanë pretenduar se ata janë pronarët e kësaj prone në pajtim me Vendimin e Komisionit për Kthimin e Tokës, Nr.464-462 të dt.21 prill 1992 dhe se bazuar në këtë vendim, paditësit kanë inicuar ndryshimet në shënimet kadastrale dhe kanë marrë fletën poseduese, nr.. të dt.. tetor .. në emrin e tyre, se me 23 shtator 2008, Agjencia Kadastrale e Kosovës e refuzoj kërkesën e paditësve për të regjistruar pronën në emrin e tyre e duke u arsyetuar se toka është privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe se kjo lëndë, ka qenë e regjistruar si lëndë, SCC – 09 – 022 dhe se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, me aktvendimin e saj, SCC – 09 – 022 të dt.07.korrik 2009, padinë e paditësve e ka refuzuar si të pa pranueshme sepse e njëjta nuk i ka përmbushur kriteret e pa pranueshmërisë dhe duke u bazuar në nenin 28.4 të UA të UNMIK-ut, Nr.2008/6 e më gjerësisht si në këtë aktvendim.

Paditësit, tani sërish me dt.05.11.2009, pranë DhPGjSK-së, kanë paraqitur padinë kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për anulimin e kontratës së Privatizimit, Nr... dhe se në këtë padi, kanë theksuar se ata janë pronarë të vetëm të parcelave të tokës, nr., nr., nr., nr. dhe nr. të regjistruara në fletën poseduese, nr., Komuna e Fushë Kosovës, Zona Kadastrale, B dhe se pronësia e tyre bazohet në Vendimin e Komisionit për Kthimin e Tokës, Nr.464-462 të dt.21 prill 1992, Fushë Kosovë dhe se bazuar në këtë vendim, paditësit kanë inicuar ndryshimet në shënimet kadastrale dhe kanë marrë fletën poseduese, nr.. të dt.. tetor .. në emrin e tyre, se me 23 shtator 2008, Agjencia Kadatrale e Kosovës e refuzoj kërkesën e paditësve për të regjistruar pronën në emrin e tyre e duke u arsyetuar se toka është privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe se kjo lëndë, ka qenë e regjistruar si lëndë, SCC – 09 – 0204.

Tutje paditësit në këtë padi, kanë shtuar se gjatë vitit 2004, janë vënë në dijeni se pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës – Drejtoria për Urbanizëm, Gejodezi dhe Kadastër dhe Pronë, Fushë Kosovë, është bërë – kryer ri numerimi i parcelave ashtu që parcelat kontestuese jajanë evidentuar me numrat: nr., nr., nr., nr., dhe nr., Zona Kadastrale, B dhe se për këtë arsye, kanë bërë kërkesë me nr.1230 të dt.02.11.2004 pranë Shërbimit Kadastral e që pronat e tyre, t'i regjistrojnë me numrat e rinj dhe kjo kërkesë, është refuzuar edhe pse Drejtoria për Urbanizëm, Gejodezi dhe Kadastër dhe Pronë, Fushë Kosovë, e ka njoftuar zyrtarisht AKM-në, se paditësit, M dhe V D, janë pronarë të parcelave nr., nr., nr., nr., dhe nr. dhe është cekur se ata janë pronar në bazë të Vendimit të Komisionit për Kthimin e Tokave e si prove e kanë cekur Njoftimin, nr.77 të dt.29 mars 2007 të bërë nga Drejtoria për Urbanizëm, Gejodezi dhe Kadastër dhe Pronë, Fushë Kosovë dhe i dërguar pranë AKM-së, se pas 4 viteve Agjencia Kadastrale e Kosovës, me aktvendimin e saj, 1230/2004 të dt.23 shtator 2008, e ka refuzuar kërkesën e paditësve për regjistrimin e me arsyetimin se parcelat në fjalë, janë privatizuar nga Kompania, G.P''Viktoria Invest Internacional'' dhe se në këtë atvendim, është thënë se privatizimi është kryer në bazë të Kontratës e Privatizimit, nr.596/2006 të dt.1 Nëntor 2006 dhe Deklaratën e Transferimit, Nr.596/2006 të dt.01 Nëntor 2006, e vërtetur pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, se aktvendimi i AKM-së, për privatizimin e parcelave të paditësve, M dhe V D, anjehërë nuk iu është dërguar, e duke e cekur si prove aktvendimin, 1230/2004 të dt.23 shtator 2008 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, se ata kanë qenë të shokuar për veprimin e tillë të AKM-së e kjo për arsye se ata janë në posedim të parcelave kontestuese më se 16 vite, dhe se këto paracela i shfrytëzojnë edhe gjatë hartimit të kësaj padie.

Tutje kanë shtuar se duke qenë se DhPGjSK-ja, deri më tani nuk ka vendosur në meritat e kërkesës, parashtruesit e kërkesës, besojnë se tani kërkesa e tyre, është e plotë, dhe i kanë propozuar DhPGjSK-së, se pas rekapitulimit të fakteve të rastit dhe shqyrtimit të provave të marr aktgjykim e me të cilin, do të anuloh Kontratës e Privatizimit, nr.. të dt.. Nëntor . të lidhur në mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë lidhur me pronat në ngastrat kadastrale, nr., nr., nr., nr. dhe nr.. sipas listës poseduese, nr., Komuna e Fushë Kosovës, Zona Kadastrale, B, e cila ka efekt të privatizimit të këtyre pronave nga Kompania, G.P''Viktoria Invest Internacional'', të anuloh Deklaratën e Transferimit, Nr.596/2006 të dt.01 Nëntor 2006 e vërtetuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me 1 Nëntor 2006 lidhur me konfirmimin e të drejtave të tyre të pronësisë për parcelat e tokës, nr., nr., nr., nr. dhe nr. me qirambajtje 99 vite nga KBI, ''Kosova Export'' dhe Ndërmarrja Shoqërore, ''Blegtoria – Lavërtaria'', dhe të vërtetohet se paditësit, M D nga V B e Republikës së Serbisë dhe V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, janë të vetmit dhe ekskluzivisht pronarë të ngastrave kadastrale, nr.. nr., nr., nr. dhe nr., Zona Kadastrale, B, si dhe se ky aktgjykim i DhPGjSK-së do të jetë bazë me efekt të ndryshimit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës e më gjerësisht si në këtë padi.

Me dt.23.11.2009, D R nga Këshilli Danez i Refugjatëve, e ka njoftuar DhPGjSK-në, se e revokon autorizimin e dhënë nga paditësi për t'i përfaqësuar pran kësaj gjykate.

Paditësi, kësaj padie, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse të cilat kanë qenë pjesë e padisë, SCC – 09 – 0204 dhe atë ; kopjen e kërkesës së dt.23.11.2004 për bartjen e patundshmërisë së paditësve të drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Fushë Kosovës; kopjen e shkresës së transaksionit të dt.22.11.2004; kopjen e aktvendimit të Agjencia Kadatrale e Kosovës - Zyra Komunale e Kadastrit në Fushë Kosovë, nr. Protokoli, 1230/2004 të dt.23.09.2008 për refuzimin e kërkesës së paditësve për regjistrimin e pronave; kopjen e kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Fushë Kosovës, Nr.77 të dt.29.03.2007 të drejtuar Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit në Prishtinë për furnzim me shënime kadastrale për M dhe V D; kopjen e aktvendimit, nr.613/2007 të dt.26.03.2007 të Drejtorisë për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Fushë Kosovës për aprovimin e kërkesës së F K për ''Viktoria Invest Internacional'' sh.p.k për kompaninë, NEWCO ''Lavërtaria - Blegtori''sh.p.k; kopjen e certifikatës mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshjme të dt.23.09.2008 për kompaninë NEWCO ''Lavërtaria - Blegtori''sh.p.k (qirambajtje 99 vite); kopjen e propozimit të dt.15.04.1991 të paditësve për kthimin e tokës të drejtuar Sekretariatit për Financa – Shërbimit për punë pronësoso – juridike – Komisionit për kthimin e Tokave të Komunës së Prishtinës; kopjen e procesverbalit, 09, nr.980 – 453/92 - 10 të dt.24.02.1992 lidhur me eksproprijimin e patundshmërive; kopjen e aktvendimit të Komisionit të Rrethit për Fondin e Tokës Bujqësore, nr.45 të dt.29. 09.1953; kopjen e Fletës poseduese, nr. të dt.. për pronat kontestuese, kopjen e aktvendimit të Komisionit për Kthimin e Tokës, Nr.464-462 të dt.21 prill 1992, Fushë Kosovë; kopjen e autorizimit të dt.03.11.2008 të dhënë nga paditësit, M D nga V B, Republika e Serbisë për këshilltaren ligjore, D R nga Këshilli Danez për Refugjatë; kopjen e shkresës së AKP-ja e dt.04.03.2009 për paditësin, M D; kopjen e shkresës – përgjigjjes së dt.16.03.2009 të bërë nga D R në shkresën e AKP-së (në gjuhën angleze); kopjen e shkresës së Fondit Republikan të Serbisë për të punësuarit – Filiala në Mitrovicë dhe kopja e ID-së së paditsit, M D, origjinalin e padisë së dt.16.03.2009 të të autorizuarit të paditësit, D R nga KDR (DCR) me të gjitha provat e cekura më lartë.

Me dt.25.02.2010, e paditura, AKP, duke vepruar sipas aktvendimit të kësaj gjykate, SCC- 09 – 0204 të dt.21.01.2010, ka paraqitur Mbrojtje në padi e në të cilën ka përshkruar përmbajtjen e padisë së paditësve rreth anulimit të kontratës në fjalë të privatizimit se paditësit pretendimin e vet e mbështesin në faktin se janë pronarë të ngastrave kadastrale, nr., nr., nr., nr. dhe nr. e të cilat evidentohen në fletën poseduese, nr. e të cilat AKP-ja, i ka privatizuar në bazë të kontratës së Privatizimit, nr.596/2006 dhe se këto ngastra, në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Pronë në Fushë Kosovë, me aktvendimin, nr.613/2007 të dt.26.03.2007, janë regjistruar në emër të pronarit të ri, F K e të cilat prona deri në momentin e privatizimit, kanë qenë të regjistruara në emër të NSh, Lavërtaria – Blegtoria”, Miradi e Epërme në Fushë Kosovë, se paditësit, kërkesën e tyre e mbështesin në Vendimin e Komisionit për Kthimin e Tokës, Nr.464-462 të dt.21 prill 1992 dhe se kanë deklaruar se me vendimin nr.45 të marr nga Komisioni i Rrethit për Fondin e Tokës Bujqësore, i cili me dt.29 Shtator 1953, paraardhëses së tyre, të ndjerës, K D, të vejës së B D nga fshati B, ia kanë marrë për shpërblim, 09,96,57 ha si dhe po ashtu paditësit, në këtë kërkesë/padi, kanë shtuar se në kërkesën e tyre të paraqitur komisionit për kthimin e tokës së dt.15.04.1991, deklarojnë se nuk kanë njohuri se kush është duke shfrytëzuar ngastrat në fjalë por vetëm se e kanë të njohur faktin se pasuria e paraardhësve të tyre, është marrë për krijimin e Fondit bujqësor të viti 1953, dhe se padisë të njëjtës kërkesë për anulimin e kontratës së shitëblerjes me nr.. e kanë paraqitur me 4 mars 2-009 në DhPGJSK e cila nga trupi gjykes i kësaj

Dhome, me aktvendimin e saj, SCC – 09 – 022 të dt.07 korrik 2009, padinë e paditësve e ka refuzuar si të pa lejuar (numri i lëndës, SCC - 09 – 022) dhe i ka propozuar gjykatës që pss shqyrtimit dhe administrimit të provave, të merr akgjykim e me të cilin, e hudh poshtë si të pa pranueshme padinë e paditësve, M dhe V D për shkak të mungesës së legjitimacionit aktiv ose në të kundërtën, të mer akgjykim e me të cili do t’a refuzoj kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar e më gjerësisht si në këtë mbrojtje dhe se kësaj mbrojtjeje ia ka bashkangjitur provat gjegjëse.

Me dt.21.04.2010, Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), me Urdhrin e saj, SCC – 09 – 0204 të dt.21.04.2010, një ekzeplar të Mbrojtjes së të paditurës, ia ka dërguar paditësve për të paraqitur Përgjigjen në Mbrojtjen e të paditurës.

Me dt.03.06.2010, paditësit, përmes të të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur Përgjigjje në mbrojtjen e të paditurës, AKP-së e në të cilën kanë theksuar në mes tjerash se nuk nuk qëndorn pretendimi i të paditurës se ata nuk e kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë sepse ata me rastin e paraqitjes së padisë, janë të legjitimuar si pronarë që nga viti 1992 e që prej asaj date, as paditura e askush tjetër nuk ka deklaruar asnjë kundërshtim e kjo në bazë të nenit 40 par.2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendor (Ligji, Nr.03/L – 154), se paditësit janë në posedim të pa ndërprerë 10 vite dhe se të njëjtët janë të regjistruar si posedues pronësor në kadastrë, e që shihet qartë se ata e kanë pronësinë në patundshmëritë kontestuese (lëndore), se ata kanë sqaruar çështjen e historikut të pronësisë nga paraardhësja e tyre juridike, K D kanë referuar në dispozitat e nenit 1 të Ligjit për mënyrën dhe kushtet e pranimit të të drejtave dhe kthimit të tokës e cila është bërë pronë shoqërore në bazë të Fondit Bujqësor të Tokave dhe për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga blerja e prodhimeve bujqësore, (Gazeta zyrtare e R të Serbisë Nr.18/91) , kur i është kthyer toka, në procedurën e zhvilluar për këtë çështje dhe kanë referuar në vendimin e viti 1992 si dhe kanë shprehur edhe qëndrimin e tyre se privatizimi i parcelave, është bërë në mënyrë të kundërligjshme nga AKM-ja si dhe i kanë kërkuar si plotësim të padisë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe se kësaj Përgjigjeje në mbrojtje, ia kanë

bashkangjitur, kopjen e autorizimit të dt.15.05.2010 të dhënë nga paditësit për av. D L nga fshati B, Komuna e Fushë Kosovës.

Me dt.11.06.2010, Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), me Urdhrin e saj, SCC – 09 – 0204 të dt.11.06.2010, një ekzemplar të kësaj Përgjigjeje, i ka dërguar të paditurës.

Me dt.29.06.2010, e paditura, ka paraqitur Kundërpërgjigje në këtë Përgjigje të paditësve e në të cilën, kanë kundërshtuar thëniet në këtë Përgjigje e duke theksuar se është e paqëndrueshëm përgjigjja e paditësve se ata kanë legjitimacion aktiv, si dhe ka ngelur pranë pretendimeve të cekura si në mbrojtjen e saj e duke i kundërshtuar të gjitha pretendimet e paditësve si në padi ashtu edhe Përgjigjen e tyre të dhënë në mbrojtjen e të paditurës rreth mënyrës së kthimit të tokave si dhe për anulimin e kontratës në fjalë të privatizimit e më gjerësisht si në këtë Kundërpërgjigje dhe se një ekzemplarë të kësaj Kundërpërgjigjeje, gjykata ua ka dërguar paditësve.

Me dt.06.07.2016, ia autorizuari i paditësve, i është drejtuar DhPGJSK-së me Urgjencën e 06.07.2011 e në të cilën e njofton gjykatën se e paditura, e ka bërë rrethimin me tela të ngastrës nr., në vendin e quajtur, ''..' në sipërfaqe prej 1,94.50 ha, lista poseduese, nr.. ZK, B dhe se në këtë ngastër ka mbjellur fidane, ka hapur një bunar etj dhe se kësaj urgjence, ia ka bashkangjitur një foto nga vendi i kësaj ngastreje.

Me dt.07.05.2024, DhPGJSK-ja, me udhryn e saj, SCC - 09 – 0204 të dt.07.05.2024, ka caktuar seancën dëgjimor për dt.07.06.2024.

Me dt. 07.06.2024, DhPGJSK-ja, ka mbajtur seancën dëgjimore e në të cilën, morën pjesë palët ndërgjyqëse dhe se e njëjt seancë dëgjimore, është shtyre për shkak të mos plotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e saj.

Me dt.01.07.2024, av.J F nga Graçanica, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtresën e dt.25.06.2024 e me të cilën e ka bërë rregullimin dhe precizimin e padisë në kuptimin subjektiv e në të cilën në mes tjerash ka cekur se njëri nga paditësit, V Dnga nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, me dt.12.08.2021, ka vdekur dhe se kësaj parashtrese, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse e të cilave edhe Certifikatën e vdeljes së paditësit, V .. të dt... të lëshuar nga Zyra e gjendjes Civile në Fushë Kosovës e sipas sëcilës, provohet se njëri nga paditësit, V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, ka vdekur me dt.12.08.2021 në Beograd të Republikës së Serbisë.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Procesi gjyqësor në këtë çështje juridike, duhet të ndërpritet dhe atë për shkak të vdekjes së njërit nga paditësit, V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1. pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-086 të Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar me Ligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme dhe se kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Kolegji, vendosi të mbaj seancën dëgjimore mirëpo kjo seance dëgjimore, është shtyer për shkak të mos plotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e saj.

Po ashtu në nenin 277 par.1 pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se: *“Procesi gjyqësor, ndërpritet : a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale , b) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdesë ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”*. Pastaj me nenin 280 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është e përcaktuar se : *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet gjykata i thërret palët”* derisa në nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se : *“Neni 280 i ligjit bazik, paragrafi 4, togfjalëshi “me propozimin e palës” fshihet nga teksti i ligjit”*.

Me dt.07.05.2024, DhPGJSK-ja, me udhryn e saj, SCC - 09 – 0204 të dt.07.05.2024, ka caktuar seancën dëgjimor për dt.07.06.2024.

Me dt.07.06.2024, Kolegji i DhPGJSK-së, ka mbajtur seancën dëgjimore e në të cilën, morën pjesë për paditësit, av. J Fnga Graçanica me autorizim zëvendësues dhe pala e paditur, AKP-ja me përfaqësuesin e saj, N Xh .

Në seancës dëgjimore, Kolegji i kësaj gjykate, pasi konstatoj se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës dëgjimore, mori aktvendim që të shtyjej seancës dëgjimore dhe se seanca e radhës do të caktohet sipas plantit të kësaj gjykate.

Me dt.01.07.2024, av.J F nga Graçanica, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtresën e dt.25.06.2024 e me të cilën e ka bërë rregullimin dhe precizimin e padisë në kuptimin subjektiv e në të cilën parashtresë në mes tjerash ka cekur se njëri nga paditësit, V D nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, ka vdekur me dt.12.08.2021, dhe se kësaj parashtrese, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse e të cilave edhe Certifikatën e vdekjes së paditësit, V.. të dt.. të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Fushë Kosovë e sipas së cilës, provohet se njëri nga paditësit, V D nga nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, ka vdekur me dt.12.08.2021 në Beograd të Republikës së Serbisë.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës si dhe se me vdekjen e njërit nga paditësit, të autorizuarit të deritanishëm, av.D L nga Graçanica, i është shuar autorizimi për përfaqësim për këtë paditës, e meqë gjykata edhe sipas detyrës zyrtare duhet të kujdeset për zotësinë procedurale të palëve në procedurë siç është në rastin konkret në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata nuk i përjashton mundësinë që trashëgimtarët e tyre ligjor në cilësi të paditësve, t'a marrin përsipër procedurën e ndërprerë gjyqësore si dhe të njëjtët, gjykata i udhëzon se me rastin e propozimit eventual të tyre mbi vazhdimin e procedurës, propozimit për vazhdimin e procedurës së ndërprerë për shkak të vdekjes së paditësit, V D nga nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës, t'ia bashkangjesin edhe dokumentin gjegjës e me qëllim që t'a dëshmojnë legjitimitetin e tyre aktiv pranë kësaj gjykate në këtë çështje juridike kontestimore, andaj me arsyet e cekura më lartë, Kolegji i kësaj gjykate, vendosi që të ndërprerë procesin gjyqësor në këtë çështje juridike kontestimore dhe atë për shkak të vdekjes së njërit nga paditësit, V D nga nga fshati B i Komunës së Fushë Kosovës.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, 76 par.3 të Ligjit, Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) lidhur me nenin 277 par.1 pika a) dhe b) dhe nenit 280 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe nenit 19 të Ligjit Nr.04/L-118 të dt.13.09.2012 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2023:290385, 09.07.2024

Kolegji i shkallës së I-rë

Agron J. Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Hasim Sogojeva, gjykatës, anëtar _____

Murat Hulaj, gjykatës, anëtar _____

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).